Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 17 maj 2016

Lënda nr. 08/10

Tomë KRASNIQI

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 17 maj 2016,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Marek Nowicki, kryesues
Christine Chinkin
Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 8 mars 2010 dhe është regjistruar po të njëjtën ditë.

2. Më 15 mars 2010 dhe 11 maj 2010, ankuesi i ofroi informata shtesë Panelit.

3. Më 11 prill 2012, Paneli njoftoi për ankesën Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e saj.

4. Më 12 prill 2012, ankuesi i dorëzoi dokumentacionin shtesë Panelit. Për këtë dokumentacion shtesë u njoftua më pas PSSP-ja më 14 maj 2012.

5. Më 31 maj 2012, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

6. Më 26 shtator 2012, Paneli ia përcolli komentet e PSSP-së ankuesit, duke e ftuar atë të japë komente shtesë nëse ai dëshiron ta bëjë këtë.

7. Ankuesi ia ofroi përgjigjen e vet Panelit në një letër të datës 2 tetor 2012.

8. Më 6 qershor 2013, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme pjesërisht.

9. Më 13 qershor 2013, Paneli ia përcolli vendimin PSSP-së, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës. Nuk është pranuar asnjë përgjigje.

10. Më 13 nëntor 2013, dhe përsëri më 28 janar 2014 dhe 18 shtator 2014, Paneli ia përsëriti kërkesën e vet PSSP-së për t'i ofruar komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë. Nuk është pranuar asnjë përgjigje.

11. Më 4 dhjetor 2014, PSSP-ja kërkoi nga Paneli një "këshillë *a priori*" lidhur me mundësinë e tërheqjes së vendimit të vet mbi pranueshmërinë për shkak të pjesëmarrjes në vendim të anëtarit të Panelit, Marek Nowicki. Në lidhje me këtë, PSSP-ja iu referua rregullës 12.1 të Rregullores së punës së Panelit.

12. Më 22 tetor 2014 dhe përsëri më 12 shkurt 2015, ankuesi i ofroi informata shtesë Panelit. Më 29 prill 2015, Paneli iu përgjigj ankuesit.

13. Më 2 mars 2015, Paneli i kërkoi PSSP-së ta qartësojë nëse letra e tij e 4 dhjetorit të vitit 2014 (shih § 11 më lart), duhet të konsiderohet se e ngrit çështjen e pranueshmërisë, pasi ankesa ishte shpallur e pranueshme në pajtim me nenin 2.3 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2009/1 *për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut*, dhe në cilat nga bazat e theksuara aty. Paneli, po ashtu, i kërkoi PSSP-së të ofrojë dokumentacion relevant dhe mbështetës.

14. Më 25 gusht 2015, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut dhe paraqiti komente shtesë mbi pranueshmërinë e ankesës në pajtim me nenin 2.3 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2009/1 të përmendur më lart. Në letrën e njëjtë, PSSP-ja i kërkoi Panelit ta marrë në konsideratë tërheqjen e anëtarit të Panelit, Marek Nowicki, nga rasti para publikimit të të gjeturave të veta. Megjithatë, asnjë dokumentacion mbështetës nuk i është paraqitur nga PSSP-ja në mbështetje të kësaj kërkese.

15. Më 11 dhjetor 2015, Paneli, pa praninë e anëtarit në fjalë të Panelit në pajtim me rregullën 12. 2 të Rregullores së punës të Panelit, diskutoi dhe përfundoi se asnjë bazë apo element objektiv nuk është paraqitur nga PSSP-ja për të vënë në pyetje paanësinë e z. Marek Nowicki dhe si rrjedhim përshtatshmërinë e pjesëmarrjes së tij në këtë rast (shih GJEDNJ [DHL], *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, nr. 39343/98, 39651/98, 43147/98 dhe 46664/99, vendimi i 6 majit të vitit 2003, në §§ 195-202; dhe GJEDNJ, *Perote Pellon kundër Spanjës*, nr. 45238/99, vendimi i 25 korrikut të vitit 2002, në § 51).

16. Po të njëjtën ditë, 11 dhjetor 2015, Paneli diskutoi në përbërje të plotë në pajtim me nenin 2.3 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2009/1 dhe hodhi poshtë çështjen e re të pranueshmërisë të ngritur nga PSSP-ja në letrën e tij të 25 gushtit të vitit 2015. Prandaj, ai e konfirmoi ankesën si të pranueshme.

17. Më 15 dhjetor 2015, Paneli ia përcolli një njoftim PSSP-së, duke e informuar atë për diskutimin e tij të çështjes së përbërjes së Panelit dhe vërejtjeve mbi pranueshmërinë e ankesës (shih §§ 14 dhe 15 më lart) dhe i kërkoi PSSP-së t'i ofrojë komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës.

18. Më 9 shkurt 2016, Paneli pranoi komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës.

II. FAKTET

A. Historiku i reformës pensionale në Kosovë

19. Para konfliktit, Kosova ishte e përfshirë në Sistemin pensional jugosllav. Në kuadër të këtij sistemi, dhe deri më 1989, Krahina Autonome e Kosovës kishte një Fond pensional autonom që mblidhte kontributet dhe paguante përfitimet. Sistemi, në atë kohë, ishte një sistem solidariteti brezash, i njohur si sistemi "pay-as-you-go" (paguaj dhe merr po aq), përmes të cilit punëtorët aktivë paguan kontributet për t'i financuar përfitimet e pensionistëve të tanishëm. Pensionet administroheshin nga "Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor" i cili, megjithatë, ishte me qendër në Beograd që nga viti 1989.

20. Pas përfundimit të konfliktit, Kosova është vendosur nën administrimin e UNMIK-ut në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999) të 10 qershorit të vitit 1999. Sipas kësaj rezolute, mandati i UNMIK-ut përfshinte "kryerjen e funksioneve themelore civile administrative" dhe "mbështetjen e rindërtimit të infrastrukturës kryesore dhe rindërtimin tjetër ekonomik", ndërsa zhvillohen dhe transferohen gradualisht kompetencat tek Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ-të).

21. Meqenëse pagesa e pensioneve nga Beogradi u ndërpre, me Rregulloren nr. 2001/35 *mbi Pensionet në Kosovë* të 22 dhjetorit të vitit 2001 (më vonë të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/20 të 19 prillit të vitit 2005) UNMIK-u krijoi një skemë të re pensionale në Kosovë, e cila ofronte pensione "bazë" (për moshën e vjetër, jokontribuuese) dhe pensione të obligueshme individuale "për kursime" (për kontribuuesit). Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/15 të 26 korrikut të vitit 2002, pagesa e një pensioni bazë hyri në fuqi prej 1 korrikut të vitit 2002, në shumë prej 28 eurosh në muaj, për të gjithë ata nga mosha 65 vjeç e më lart, pavarësisht nga kontributet në të kaluarën. Sipas rregullores së njëjtë, në vitet në vijim do të vendosej çdo vit lartësia e pensionit bazë nga Ministria e Financave e IPVQ-ve duke u bazuar në shportën ushqimore lidhur me kaloritë minimale që shërben si standard për nevoja themelore konsumimi[1].

[1] Shih: Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/15 të 26 korrikut të vitit 2002, *mbi Shpalljen e një Ligji të Miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Metodologjinë për Vendosjen e Nivelit të Pensionit Bazë në Kosovë, dhe Caktimit të Datës së Fillimit të Ofrimit të Pensioneve Bazë*.

22. Shuma e pensionit bazë u ngrit në 35 euro në vitin 2002, në 40 euro në muaj në vitin 2004 dhe më vonë, në vitin 2009, në 45 euro në muaj. Në vitin 2007, Udhëzimi Administrativ nr. 11/2007 i Qeverisë së Kosovës mbi Ekzekutimin e Vendimit të Qeverisë nr. 13/277, vendosi të drejtën e rritjes së pensionit bazë në një total prej 75 eurosh në muaj për të gjithë ata të cilët mund të ofrojnë dëshmi se kishin paguar kontribute në kuadër të sistemit të ish-Jugosllavisë për 15 vjet.

B. Ankesat dhe procedurat në lidhje me pensionin të ankuesit

23. Ankuesi është banor i Kosovës që banon në Komunën e Pejës. I lindur në vitin 1938, ankuesi ka paguar në Fondin shtetëror pensional të Republikës Federale të Jugosllavisë, "Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor", duke fituar të drejtën në pension që nga 3 maji i vitit 1998. Ai deklaron se, ai e pranoi një pension në shumën prej përafërsisht 180 eurosh në muaj nga ajo datë deri më 1 dhjetor 1998. Pas kësaj date, ky pension është ndërprerë pa iu ofruar ankuesit ndonjë njoftim apo sqarim paraprak.

24. Ankuesi deklaron se pas themelimit të UNMIK-ut në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999) atij, së bashku me shqiptarët e tjerë, iu ndalua marrja e këtij pensioni. Ankuesi pohon se serbët nga Kosova vazhduan të pranojnë këtë pension.

25. Ankuesi deklaron se, që nga viti 2000, ai iu drejtua edhe UNMIK-ut, edhe autoriteteve lokale për të kërkuar rifillimin e pagesës së pensionit të tij kontribuues, por pa dobi.

26. Sipas dokumentacionit që i është paraqitur Panelit, më 11 dhjetor 2006 ankuesi i shkroi një letër PSSP-së në lidhje me këtë. Me anën e një letre të datës 1 shkurt 2007, ushtruesi i detyrës së zëvendësit të PSSP-së, u përgjigj në emër të PSSP-së, se letra e ankuesit ngriti një "çështje shumë të rëndësishme dhe komplekse". Megjithatë, pasi pensionet dhe mirëqenia sociale ishin "kompetenca të transferuara", me të cilat merrej Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) e IPVQ-e, ajo binte "jashtë përgjegjësisë së drejtpërdrejtë të UNMIK-ut". ZPSSP-ja këshilloi ankuesin t'i drejtojë shqetësimet e veta drejtpërdrejtë te Kuvendi i Kosovës dhe MPMS me qëllim që të "kërkojë një zgjidhje të kësaj situate".

27. Më 11 prill 2007, ankuesi i paraqiti një ankesë Departamentit të Administratës së Pensioneve në Kosovë (DAPK) të MPMS-së së Kosovës, duke kërkuar pagesën e pensionit të marrë sipas ish-sistemit jugoslllav. Më 13 prill 2007, DAPK i dërgoi një përgjigje me shkrim ankuesit duke theksuar se mospagesa e pensionit kontribuues ndodhi për shkak "të fondeve të vjedhura nga okupatorët serbë", që përbënte një "problem të pazgjidhur politik" dhe e informon ankuesin për skemat pensionale në rrjedhë e sipër të administruara nga DAPK.

28. Me sa shihet më 30 prill 2007, pas një ankese të paraqitur nga ankuesi më 16 prill 2007, DAPK mori një vendim që të njihte të drejtën e ankuesit në një pension moshe/bazë, "të fituar përmes kontributeve në Fondin pensional dhe invalidor nga dhjetori i vitit 1998 dhe më tutje". Ankuesi deklaron se në këtë sistem, nga një datë e paspecifikuar, ai e ka pranuar një pension nga DAPK prej afërsisht 45 eurosh në muaj. Ankuesi e paraqet një certifikatë nga DAPK të datës 24 shkurt 2010, e cila e konfirmon këtë shumë.

29. Më 4 maj 2007, ankuesi filloi procedurat gjyqësore në Gjykatën Themelore (atëherë të njohur si Gjykata Komunale) në Prishtinë kundër MPMS-së, duke kërkuar "rikthimin e

statusit të tij si një pensionist kontribuues", pagesat e shumave të datave të cekura nga e kaluara, të cilat ai pohonte se paraqisnin borxh ndaj tij pas ndërprerjes së pagesës së pensionit të tij dhe të kompensohet për dëmin e shkaktuar për shkak të kësaj ndërprerje. Më 7 janar 2013, Gjykata Themelore hodhi poshtë kërkesën e ankuesit të bazuar në mungesën e "legjitimitetit pasiv" të MPMS-së së Kosovës, meqë në pajtim me nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/01 *mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë*, të gjitha kompetencat legjislative dhe ekzekutive në Kosovë ishin marrë nga UNMIK-u në periudhën relevante.

30. Më 7 tetor 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë hodhi poshtë kërkesën e ankuesit, duke mbështetur arsyetimin e Gjykatës Themelore. Në vendimin e vet, Gjykata e Apelit deklaroi se "Fondi pensional para luftës, dhe Fondi i tanishëm pensional i Kosovës nuk paraqesin vazhdimësi, dhe rrjedhimisht, pala e paditur nuk e ka për obligim t'i paguajë fondet që ishin marrë nga shteti serb, një çështje e cila do të jetë temë në marrëveshjet ndërmjet shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë […]".

31. Më 12 shkurt 2014, Gjykata Supreme e Kosovës hodhi poshtë ankesën e ankuesit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë të përmendur më lart. Në vendimin e Gjykatës Supreme thuhet se e drejta e ankuesit për pension bazë në kuadër të sistemit të Kosovës ishte njohur që nga 3 maji i vitit 2003, së pari në shumën prej 35 eurosh, e më pas prej 45 eurosh. Në vendim, po ashtu, thuhet se, prej 23 shtatorit të vitit 2009, ankuesi e pranoi një pension në shumën prej 45 eurosh plus 35 euro shtesë, duke u bazuar në kontributet e tij të mëparshme në sistemin e ish-Jugosllavisë, që paraqiste një shumë të grumbulluar prej 80 eurosh.

32. Më 22 shkurt 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e gjykoi si të pabazë ankesën e ankuesit se vendimet e instancave më të ulëta i kishin shkelur të drejtat e tij të njeriut.

III. ANKESA

33. Duke pasur parasysh se ankesa është shpallur e pranueshme, ankuesi ankohet se nga 12 dhjetori i vitit 1998 deri në muajin prill të vitit 2007, ai nuk ishte në gjendje të pranojë pensionin e tij duke u bazuar në vitet e kontributit të tij në Fondin Jugosllav për Pensionistë dhe Persona Invalidorë. Ai e fajëson UNMIK-un që nuk i gjeti një zgjidhje këtij problemi, ashtu që ai të mund të vazhdojë të pranojë një pension si "pensionist kontribuues". Ai pohon se kjo është në shkelje e së drejtës së tij për ta shfrytëzuar i qetë pasurinë në pajtim me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

34. E dyta, ankuesi ankohet në esencë se, për shkak të mospagesës së pensionit të tij "kontribuues" gjatë periudhës prej vitit 1999 deri më 2007, dhe për shkak të pamjaftueshmërisë të pensionit të moshës që i është dhënë atij pas kësaj, ai ka mbetur pa mjete financiare për të mbajtur veten. Në lidhje me këtë, ankuesi pretendon në shkelje të së drejtës së tij për sigurim social dhe për standard adekuat të jetës të garantuar me nenet 9 dhe 11 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK), si dhe në shkelje të së drejtës së tij për të qenë i lirë nga trajtimi johuman dhe degradues e garantuar me nenin 3 të KEDNJ-së.

IV. LIGJI

A. Parashtresat e palëve

1. Parashtresat e ankuesit

35. Ankuesi ankohet se, që nga viti 1999, ai nuk e ka pranuar pensionin kontribuues i dhënë në kuadër të kornizës ligjore në fuqi në kohën e "ish-Jugosllavisë". Ai, po ashtu, thekson që gjatë periudhës 1999-2007 ai nuk ka pranuar fare pension dhe, që për shkak të mosveprimit të UNMIK-ut (dhe autoriteteve të Kosovës) ankuesi u kthye nga "një pensionist me të drejta" në "një lypës të vërtetë që jeton nga mëshira e të tjerëve". Ankuesi deklaron se, duke filluar nga viti 2007, ai e ka pranuar një pension të moshës prej 45 eurosh nga DAPK në Kosovë i cili, megjithatë, nuk mjafton madje as për të blerë barna.

36. Ankuesi deklaron se ai iu drejtua UNMIK-ut dhe autoriteteve të Kosovës për këtë çështje, duke përfshirë mënyrën përmes procedurave gjyqësore, por pa dobi. Për shembull, ai deklaron se asnjë nga autoritetet në fjalë nuk është e gatshme të marrë përgjegjësinë për këtë çështje. Qeveria e Serbisë sqaron se ajo ndërpreu mbledhjen e kontributeve nga Kosova, dhe kështu ajo nuk mund t'ua paguajë pensionet "Kosovarëve". Ai, po ashtu, deklaron se UNMIK-u hedh poshtë çdo përgjegjësi. Autoritetet e Kosovës pohojnë t'i kenë marrë "të drejtat" nga shpallja e njëanshme e pavarësisë por nuk duan të pranojnë ndonjë "obligim" përkatës.

37. Sa i përket përgjegjësisë së UNMIK-ut, ankuesi deklaron se, pas miratimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) dhe themelimit të UNMIK-ut si administratë e përkohshme në Kosovë, PSSP-së i janë dhënë të gjitha fuqitë legjislative dhe ekzekutive në Kosovë. Ankuesi deklaron se si pasojë UNMIK-u e kishte për obligim të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të gjithë personat që jetojnë në Kosovë dhe që këto të drejta përfshinin të drejtën në pronë që rrjedh nga të drejtat në pension. Ankuesi, po ashtu, deklaron se deri me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, madje edhe kur kompetenca të caktuara ishin transferuar nga UNMIK-u tek IPVQ-të, PSSP-ja ruajti përgjegjësinë e përgjithshme mbi IPVQ-të, duke përfshirë autoritetin që të marrë "masa adekuate kundër veprimeve që ishin në mospërputhje me Kornizën Kushtetuese" të Kosovës.

38. Për sa i përket shkeljes së pretenduar të të drejtave të tij si rezultat i mospagesës së pensionit të tij, ankuesi deklaron se ishte përgjegjësi e UNMIK-ut t'i marrë disa veprime me qëllimin që ta ndihmojnë atë dhe pensionistët e tjerë të Kosovës, në një situatë të ngjashme t'i marrin pensionet e dhëna në kuadër të sistemit të ish-Jugosllavisë. Prandaj, UNMIK-u duhet të mbahet përgjegjës për "keqmenaxhim'për shkak të dështimit e vet që ta bëjë këtë.

39. Për sa i përket shkeljes së pretenduar të neneve 9 dhe 11 të KNDESK-së dhe nenit 3 të KEDNJ-së, ankuesi deklaron se UNMIK-u e kishte për obligim sipas këtyre dispozitave t'i ndërmarrë hapat e duhur, vetë apo përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, për të siguruar realizimin e të drejtës së tij për sigurim social dhe për standard adekuat të jetës, pa diskriminim. Megjithatë, UNMIK-u nuk veproi për të siguruar realizimin e kësaj të drejte të dhënë atij dhe të lehtësojë situatën e tij të vështirë financiare, si dhe atë të pensionistëve të tjerë në situatë të njëjtë.

2. Parashtresat e PSSP-së

40. Në letrën e tij drejtuar Panelit të datës 25 gusht 2015, PSSP-ja paraqiti vërejtje shtesë ndaj pranueshmërisë së ankesës (shih gjithashtu § 14 më lart). *E para*, PSSP-ja argumenton se ankuesi dështoi t'i shterojë të gjitha mjetet juridike në dispozicion në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi *Themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut*. Ai argumenton se ankuesi dështoi të ofrojë dëshmi se ai ndërmori hapa për të arritur te pagesa e pensionit të tij nga autoritetet serbe; në veçanti ai nuk ka paraqitur padi kundër Serbisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

41. *E dyta*, PSSP-ja deklaroi se rasti i ankuesit mund të konsiderohet "i zgjidhur" në dritë të vendimit të marrë nga GJEDNJ në rastin *Grudiq kundër Serbisë* më 17 prill 2012, në të cilin Gjykata gjeti se Serbia e kishte shkelur KEDNJ-në për ndërprerje të pensionit të ankuesve, të dhënë përmes kontributeve në Fondin Jugosllav për Pensionistë dhe Persona Invalidorë, dega në Kosovë. PSSP-ja po ashtu theksoi që, në këtë vendim, Gjykata Evropiane kërkoi nga autoritetet serbe që të marrin hapa të duhur për të rifilluar me pagesën e pensioneve atyre që janë në një situatë të ngjashme me ankuesit në rastin *Grudiq*. Si pasojë, sipas mendimit të PSSP-së, ankuesi në këtë rast e ka humbur statusin e tij të viktimës në pajtim me nenin 37.1 të KEDNJ-së.

42. Në një letër pasuese, të pranuar nga Paneli më 9 shkurt 2016, PSSP-ja ofron komentet e tij mbi bazueshmërinë e rastit. Për sa i përket ankesës sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, PSSP-ja thekson që, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr. 1244 (1999), UNMIK-u "merr në konsideratë të plotë parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial". Prandaj, sipas mendimit të PSSP-së, "është dhe ishte jashtë mandatit të UNMIK-ut dhe kompetencës së tij që të ndikojë tek autoritetet jashtë territorit të Kosovës, duke përfshirë autoritetet e Beogradit".

43. PSSP-ja e pranon se "të ndihmuarit e një procesi politik të dizajnuar për të vendosur statusin e ardhshëm të Kosovës" është pjesë e mandatit të UNMIK-ut. Megjithatë, në rolin e vet si administrues i përkohshëm i territorit të Kosovës, UNMIK-u ishte "i kufizuar t'i adresojë çështjet me autoritetet në Beograd dhe të ndihmojë dialogun në mes palëve". Veç kësaj, çështjet siç janë çështja e pensionit kërkoi "gatishmërinë dhe pëlqimin politik", si dhe "kanale funksionale (administrative) të bashkëpunimit", elemente që mungonin në periudhën nën shqyrtim të Panelit. Në lidhje me këtë, PSSP-ja rikujton se deri në kohën e fundit Serbia ka mbajtur qëndrim se nuk e kishte për obligim t'ua paguajë pensionet të gjithë personave nga Kosova, të cilët kishin fituar të drejtat e pensionit në bazë të kontributeve të paguara në ish-Fondin shtetëror jugosllav të pensioneve prej vitit 1999.

44. PSSP-ja thekson që, megjithatë, UNMIK-u e trajtoi çështjen e pensionit me autoritetet serbe "deri në shkallën që ishte në gjendje dhe në kuadër [sic] të kufijve të detyrave të veta të mandatuara". PSSP-ja thekson që së pari, në periudhën 1999-2001, UNMIK-u takoi autoritetet e Beogradit "pa u shprehur hapur dhe në mënyrë konfidenciale".

45. PSSP-ja thekson më tutje që, pas kësaj, UNMIK-u nxori Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 të 22 dhjetorit të vitit 2001 mbi Pensionet në Kosovë, dhe ndoqi një "qasje më të institucionalizuar". Sipas PSSP-së, kjo provohet me krijimin, në pajtim me Rregulloren, të Grupit punues mbi politikat pensionale, të përbërë nga udhëheqësi i Departamentit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, drejtori menaxhues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave në Kosovë, udhëheqësi i Autoritetit Qendror Fiskal, anëtarët e

tjerë relevantë të Këshillit Ekonomik Fiskal, të caktuarit e tyre dhe të emëruarit e tjerë nga PSSP-ja.

46. PSSP-ja, po ashtu, thekson që "përpjekjet dhe masat pozitive" të UNMIK-ut për të trajtuar çështjen e pensioneve në Kosovë janë përmendur në një publikim të vitit 2003 nga Zyra (Organizata) Ndërkombëtare e Punës, i titulluar *"Vendet e punës pas lufte: një sfidë kritike në paqe dhe enigma e rindërtimit*". PSSP-ja thekson që ky publikim, në fq. 415, thotë që "në vitin 2002, negociatat filluan në mes ministrive për punë dhe mirëqenie sociale dhe administratave pensionale të Serbisë dhe Kosovës për mospagesën e pensionit të kosovarëve".

47. PSSP-ja thekson që ekzistojnë "dokumente shtesë të arkivuara dhe konfidenciale të UNMIK-ut", në të cilat përmenden negociatat e mbajtura ndërmjet autoriteteve të Beogradit dhe UNMIK-ut dhe të cilat pasqyrojnë përpjekjet e bëra nga UNMIK-u për çështjen e pensioneve. Në lidhje me këtë, PSSP-ja e përmend një "Shënim konfidencial në dosje" në lidhje me "Takimin e katërt të Grupit punues të nivelit të lartë" të mbajtur në Beograd më 31 maj 2002, në të cilin thuhet: "Grupit punues i është kërkuar, po ashtu, t'i marrë dy tema të mëdha: […] dhe pensionet". Veç kësaj, PSSP-ja i referohet "korrespondencës konfidenciale me e-mail" në mes anëtarëve të stafit të UNMIK-ut, të datës 5 qershor 2002, të titulluar "Negociatat për pensione në Beograd", që i referohet një takimi në mes të zyrtarëve të UNMIK-ut dhe Ministrisë për Punë Sociale të Serbisë dhe Fondit pensional serb të caktuar të mbahet më 7 qershor 2002. Sipas PSSP-së, e-mailat e tjerë ndërmjet anëtarëve të stafit të UNMIK-ut identifikojnë qëllimin e takimit si "shkëmbim i informatave mbi çështjet e pensioneve në lidhje me Kosovën, me qëllim sigurimin që mbrohen të drejtat e përfituesve të kualifikuar".

48. PSSP-ja argumenton më tutje që mandati i UNMIK-ut për të ndihmuar një proces politik me qëllim zgjidhjen e çështjes së statusit të Kosovës, nuk mund të interpretohet si një obligim për çështjen e pensioneve. Megjithatë, PSSP-ja thekson që "është e qartë se një marrëveshje si rezultat i një procesi politik mbi statusin final të Kosovës i ndihmuar nga përkrahja e UNMIK-ut do të kishte përfshirë një marrëveshje mbi çështjen e pensioneve". Në këtë kontekst, PSSP-ja argumenton që "draft propozimi për zgjidhjen e statusit i formuluar nën kujdesin e Të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Martti Ahtisaari", i cili është hartuar me lehtësimin dhe përkrahjen e UNMIK-ut, paraqet "një masë shtesë pozitive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë".

49. Në dritë të parashtresave më lartë, PSSP-ja thekson që nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nga UNMIK-u.

50. Sa i përket ankesës sipas nenit 3 të KEDNJ-së, PSSP-ja thekson që pas arritjes së tij në Kosovë, UNMIK-u "u përball me një numër të madh nevojash që i drejtoheshin misionit nga banorët e Kosovës", duke përfshirë ofrimin e paqes, sigurisë, dhe nevojat humanitare dhe sociale, siç është zgjidhja e çështjes së pensioneve. PSSP-ja i referohet një dokumenti teknik të vitit 2001 të Bankës Botërore, i cili thekson nevojën për reforma ekonomike dhe sociale si një parakusht për paqe në Kosovë dhe thekson prioritetet konkurruese për implementimin e një skeme të mirëqenies sociale në Kosovë, ndërsa ndihmohen përpjekjet humanitare në një situatë të "mungesës së kapacitetit administrativ". Duke cekur dokumentin teknik, PSSP-ja përmend disa nga pengesat për "rifillimin e menjëhershëm të dhënies së pensionit, siç janë

> "1) çështjet praktike për rifillimin e një sistemi pay-as-you-go (Paguaj dhe merr po aq) para rikthimit të një sistemi të tatimit në paga apo taksave në të hyrat personale; 2) pagesat mund të jenë orientuar keq, duke përfshirë vetëm proporcione të vogla krahasuese të atyre në grupet e ndryshme të cenueshme dhe pa pasur parasysh nevojën e menjëhershme […]; 3) vështirësitë operacionale në identifikimin dhe gjetjen e përfituesve; 4) çështjet që kanë të bëjnë me vlerën për sa u përket shqiptarëve etnikë, të cilët humbën të drejtat e pensionit sepse ata ishin ndaluar të punojnë në sektorin zyrtar gjatë 1990-ve (do të kërkonte vështirësi të ndryshme, siç janë dëshmia për të kaluarën në punë para vitit 1989, etj.) dhe 5) përfituesit që janë penguar për të drejtën në Fondin Pensional dhe Invalidor të Serbisë. […]"

51. Duke përmendur dokumentin e njëjtë teknik, PSSP-ja thekson se duke pasur parasysh burimet e kufizuara buxhetore në vitin 1999-2000, administrata e UNMIK-ut vendosi, në mënyrë të duhur, t'i "fokusojë burimet për transfer social në një program të përkohshëm të asistencës sociale" që nga nëntori i vitit 1999 deri në prill të vitit 2000. Nga maji i vitit 2000, një skemë e re e asistencës sociale është implementuar në faza me përkrahjen e OJQ-ve lokale dhe ndërkombëtare. Megjithatë, "programet kryesore të asistencës sociale – pensionet, shtesat e fëmijëve dhe përfitimi për të qenit i papunë – nuk janë rikthyer".

52. PSSP-ja thekson që, pas kësaj dhe për arsyet e cekura më lart, UNMIK-u filloi një reformë për sistemin e trashëguar pensional dhe paraqiti një skemë të re pensionale. PSPP-ja thekson që UNMIK-u zgjodhi të miratojë një "sistem bazik (të sheshtë) pensionimi", i dizajnuar dhe "me qëllim shmangien e diskriminimit të bazuar në historikun e punës, gjininë, apo etninë". Në të vërtetë, Rezoluta e UNMIK-ut nr. 2001/35 që krijon skemën e re pensionale në Kosovë, parashikoi sigurimin e një pensioni bazë prej 28 eurosh – i përcaktuar të jetë në përputhje me "kufirin ekstrem të varfërisë" për secilin mbi moshën 65 vjeç, pavarësisht nga punësimi i mëparshëm apo vitet e përvojës. Përveç kësaj, prej tetorit të vitit 2007, Qeveria e Kosovës, përmes një Udhëzimi Administrativ, ngriti pensionin bazë në 75 euro për personat të cilët kishin kontribuar në Fondin jugosllav të pensioneve për së paku 15 vjet dhe mund ta dëshmonin atë. Veç kësaj, sipas PSSP-së, Banka Botërore tregon në dokumentin e njëjtë teknik se "vlera reale e pensionit që është pranuar nga Serbia për përfituesit që kishin fituar të drejtën për pension nga Fondi Pensional i Serbisë prej vitit 1999 arrinte në rreth 20-30 *marka gjermane* (DM)".

53. Duke iu kthyer rastit të ankuesit, PSSP-ja vëren që, duke u bazuar në dokumentacionin që i është paraqitur Panelit, z. Krasniqi pranoi një pension prej 45 eurosh në muaj dhe nuk ka asnjë indikacion që pas Udhëzimit Administrativ të tetorit të vitit 2007, ai pranoi një rritje në pagesat e pensionit. PSSP-ja thekson që kjo rritje do të mund të "lehtësonte situatën e ankuesit dhe do të kontribuonte në përmirësimin-edhe nëse ky është i lehtë" të kushteve të tij jetësore, po ashtu duke pasur parasysh se ish-pensioni i tij do të kishte një "vlerë reale" pensioni e barasvlershme me 20-30 euro në muaj.

54. PSSP-ja thekson që Gjykata Evropiane e hodhi poshtë "nocionin që KEDNJ garanton një standard minimal të jetës", si dhe "të drejta socio-ekonomike siç janë e drejta në punë, e drejta në ndihmë falas mjekësore apo e drejta për të marrë ndihmë financiare nga shteti për të mbajtur një standard të caktuar të jetesës". Në lidhje me këtë, ai i referohet vendimeve në rastin *Panqenko kundër Letonisë* (1999) dhe *Larioshina kundër Rusisë* (2002). Në këtë të fundit, Gjykata Evropiane hodhi poshtë pretendimin e

ankueses se pensioni i saj – 653 rubla ruse në muaj të barasvlershme me 25 euro në kohën e ankesës-ishte i pamjaftueshëm për të mbajtur një standard adekuat të jetës.

55. PSSP-ja argumenton se UNMIK-u iu përgjigj çështjes së pensionit "si një administratë e përkohshme e një territori të varfëruar me burime shumë të kufizuara buxhetore dhe kundrejt një sfondi të prioriteteve konkurruese" në një ambient pas konflikti. Pavarësisht nga këto sfida, sipas mendimit të PSSP-së, UNMIK-u themeloi "një skemë pensionale që ofron një pension adekuat dhe në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut".

56. Prandaj, pretendimet për shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së, dhe nenit 9 dhe 11 të KNDESK-së nuk janë "të qëndrueshme".

B. Vlerësimi i Panelit

1. Pranueshmëria

57. Paneli rikujton që, me vendimin e vet të 6 qershorit të vitit 2013, ai shpalli ankesën të pranueshme sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, nenit 3 të KEDNJ-së, dhe neneve 9 dhe 11 të KNDESK-së. Megjithatë, para shqyrtimit të rastit për bazueshmërinë e tij, Paneli do t'i marrë në konsideratë vërejtjet shtesë për pranueshmërinë të ngritura nga PSSP-ja (shih § 14 më lart) në pajtim me nenin 2.3 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2009/01 dhe vendos ta pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të vendosura në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

58. Më 11 dhjetor 2015, Paneli mori plotësisht parasysh çështjet e pranueshmërisë, të cilat janë ngritur nga PSSP-ja në letrën e tij të 25 gushtit të vitit 2015.

59. Paneli konsideron që vërejtja se ankuesi nuk shteroi mjetet juridike *vis-à-vis* autoriteteve serbe nuk është e re, pasi ajo tanimë është ngritur nga PSSP-ja dhe hedhur poshtë nga Paneli në fazën e pranueshmërisë (shih PKDNJ, *Tomë Krasniqi*, nr. 08/10, vendimi i 6 qershorit të vitit 2013, §§ 25, 28-30). Paneli përsërit se ankesa aktuale është drejtuar kundër UNMIK-ut, jo autoriteteve serbe, siç është thënë po ashtu në vendimin e pranueshmërisë.

60. Veç kësaj, duke pasur parasysh se PSSP-ja bëri vërejtje se ankuesi nuk paraqiti ankesë në GJEDNJ, Paneli rikujton se rregulla e shterimit të mjeteve juridike u referohet vetëm mjeteve "vendore" dhe, si e tillë nuk është një kërkesë për t'i shterë mjetet juridike të parapara në kornizën e organizatave ndërkombëtare. Prandaj, Paneli konsideron se dorëzimi i ankesës në GJEDNJ, e cila qartë nuk është një mjet juridik vendor, nuk është një mjet juridik që duhet të shterohet me qëllim të paraqitjes së një ankese para PKDNJ-së, në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

61. Për më tepër, dhe duke pasur parasysh se PSSP-ja u referohet mjeteve juridike që gjoja janë vënë në dispozicion brenda procesit të implementimit të vendimit të *Grudiq*, Paneli thekson që, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, mjetet juridike vendore që një ankues kërkohet t'i shterojë janë, në parim, ato ekzistueset në momentin e dorëzimit të ankesës në Gjykatë (shih GJEDNJ [DHL], *Sejdoviq kundër Italisë*, nr. 56581/00, vendimi i 1 marsit të vitit 2006, në § 46, dhe *Paksas kundër Lituanisë*, nr. 34932/04, vendimi i 6 janarit të vitit 2011, në § 75).

62. Paneli është i vetëdijshëm se kjo rregull e përgjithshme u nënshtrohet përjashtimeve. Për shembull, GJEDNJ i ka pranuar përjashtimet në fushat e zgjatjes së procedurave, kur procedurat e reja janë paraqitur (shih GJEDNJ, *Predil Anstalt kundër Italisë* (dec.); *Bottaro kundër Italisë* (dec.), apo kur janë krijuar procedurat e reja kompensuese në rastin e shkeljes së të drejtave në pronë (GJEDNJ, *Michalak kundër Polonisë* (dec.), dhe [DHL] *Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë* (dec.)). GJEDNJ ka theksuar se ajo do të shqyrtojë rast pas rasti nëse mjetet e sapokrijuara juridike janë efektive dhe të qasshme (në GJEDNJ, *Parizov kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* (dec.), në §§ 41-47, mjeti i ri juridik nuk ishte efektiv). Në veçanti, vlerësimi nëse një mjet i ri juridik duhet të konsiderohet efektiv apo jo, duhet të bazohet në aplikimin e tij konkret (shih GJEDNJ, *Nogolica kundër Kroacisë* (dec.).

63. Paneli, duke pasur në konsideratë se vendimi *Grudiq* është marrë në prill të vitit 2012 (rreth dy vjet pasi ankuesi dorëzoi rastin e tij në Panel), dhe duke pasur në konsideratë se implementimi i vendimit të lartpërmendur është akoma në pritje dhe nën mbikëqyrjen e zgjeruar të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, nuk konsideron masat e miratuara nga Qeveria serbe deri më tani me qëllim të implementimit të vendimit që të jenë një mjet juridik që ankuesi është dashur ta shterojë. Prandaj, Paneli unanimisht e hedh poshtë vërejtjen e PSSP-së në lidhje me këtë.

64. Për sa i përket argumentit të PSSP-së në lidhje me statusin si viktimë të ankuesit, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së që një aplikant nuk e humb statusin e tij/saj si viktimë veç nëse autoritetet në fjalë e kanë pranuar, ose qartë apo në substancë shkeljen e një të drejte nga Konventa, dhe pastaj bënë korrigjim (shih GJEDNJ [DHL], *Nada kundër Zvicrës*, nr. 10593/08, vendimi i 12 shtatorit të vitit 2012, në § 128; GJEDNJ [DHL], *Gäfgen kundër Gjermanisë*, nr. 22978/05, vendimi i 1 qershorit të vitit 2010, në § 115; dhe GJEDNJ, *Scordino kundër Italisë* (Nr.1), nr. 36813/97, vendimi i 29 marsit të vitit 2006, në § 180). Në lidhje me këtë, PSSP-ja nuk ka ofruar dëshmi se ndonjë nga masat e cekura më lart janë marrë në dobi të ankuesit. Prandaj, Paneli unanimisht hedh poshtë argumentin e PSSP-së se ankuesi e ka humbur statusin e tij të viktimës.

2. Bazueshmëria

a. Shkelja e pretenduar e të drejtës në pronë

65. Ankuesi ankohet se, duke mos i marrë masat për të siguruar pagesë të pensionit që ai e kishte fituar sipas ish-sistemit jugosllav, UNMIK-u, i cili ishte mandatuar me administrimin e Kosovës pas qershorit të vitit 1999, dështoi të mbrojë të drejtat e tij në pronë në shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në veçanti ai ankohet se, në periudhën në mes vitit 1999 dhe majit të vitit 2007, ai nuk pranoi fare ndonjë pension. Pas muajit maj të vitit 2007, ai pranoi një pension bazë të moshës në pajtim me Sistemin e ri pensional në Kosovë, vlera e të cilit prej 45 eurosh megjithatë ishte shumë më e ulët sesa pensioni i tij kontribuues sipas ish-sistemit jugosllav.

66. Nga ana e tij, PSSP-ja argumenton se UNMIK-u, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr. 1244 (1999) për themelimin e mandatit të vet, respekton plotësisht parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve. Si pasojë, sipas mendimit të PSSP-së, ishte jashtë mandatit të UNMIK-ut që "të ushtrojë influencë mbi autoritetet jashtë territorit të Kosovës duke përfshirë autoritetet e Beogradit". Megjithatë, PSSP-ja thekson se UNMIK-u adresoi "çështjen e pensioneve" duke bërë një numër konsultimesh dhe takimesh "konfidenciale" me autoritetet serbe në mes vitit

1999 dhe 2002 (shih §§ 44-47 më lart). Veç kësaj, midis prioriteteve të ndryshme dhe kufizimeve buxhetore pas konfliktit, UNMIK-u po ashtu themeloi, përmes nxjerrjes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 të 22 dhjetorit të vitit 2001 *mbi Pensionet në Kosovë*, një Sistem të ri pensional në Kosovë, i cili u bë funksional që nga viti 2002.

67. Paneli rikujton që është konstatuar se të drejtat e fituara për pension konsiderohen të drejta pronësore dhe se zvogëlimi apo ndalja e pensionit rrjedhimisht mund të përbëjnë një interferencë në shfrytëzimin e qetë të pronave që mbrohet me nenin 1 të Protokollit 1 të GJEDNJ-së (shih PKDNJ, *Krasniqi kundër UNMIK-ut*, nr. 08/10, vendimi i 6 qershorit të vitit 2013, në § 29 dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së e përmendur aty).

68. Për sa i përket vërejtjes së PSSP-së se ndërmarrja e ndonjë veprimi për të "ushtruar influencë" mbi autoritetet serbe për të zgjidhur problemin e pensioneve do të ishte jashtë mandatit të UNMIK-ut (shih § 43 më lart), Paneli rikujton se kjo pjesë e ankesës ka të bëjë me dështimin e pretenduar të UNMIK-ut për t'i përmbushur obligimet e veta pozitive që rrjedhin nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë, Paneli thekson që një pjesë kryesore e mandatit të UNMIK-ut në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr. 1244 (1999) ishte t'i "promovojë dhe t'i mbrojë të drejtat e njeriut" në Kosovë. Sipas rregulloreve pasuese, UNMIK-u u zotua t'i ushtrojë kompetencat e veta në Kosovë në pajtim me "standardet e pranuara ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut" (shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1 *mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë*, në nenin 2), dhe në veçanti respektimin e instrumenteve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 *mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë*).

69. Në këtë kontekst, Paneli rikujton se neni 1 i Protokollit nr. 1 i lexuar në lidhje me nenin 1 të KEDNJ-së, kërkon nga shtetet t'i "sigurojnë secilit në kuadër të juridiksionit të tyre" që t'i gëzojnë të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në lidhje me këtë, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane, që thotë se ushtrimi efektiv i të drejtës së mbrojtur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së "nuk varet vetëm nga detyra e shtetit për të mos interferuar, por mund të kërkojë miratimin e masave pozitive të mbrojtjes … veçanërisht ku ka një lidhje të drejtpërdrejtë në mes masave që një ankues në mënyrë legjitime mund t'i presë nga autoritetet dhe të shfrytëzuarit efektiv të pronave të tij" (shih GJEDNJ, *Öneryıldız kundër Turqisë*, nr. 48939/99, vendimi i 30 nëntorit të vitit 2004, në § 134). Për sa i përket juridiksionit të UNMIK-ut *vis-à-vis* autoriteteve serbe, Paneli tanimë ka theksuar se Gjykata Evropiane ka gjetur që, në prani të një situate faktike e cila zvogëlon shtrirjen e juridiksionit të autoritetit në fjalë, dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve të veta për të drejtat e njeriut, "shteti në fjalë duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet ligjore dhe diplomatike në dispozicion të tij *vis-à-vis* shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare, të vazhdojë që të garantojë të gëzuarit e të drejtave dhe lirive të garantuara me Konventë" (shih GJEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të tjeret kundër Moldavisë dhe Rusisë*, vendimi i 8 korrikut të vitit 2004, në § 333; shih PKDNJ, *Krasniqi kundër UNMIK-ut*, përmendur në § 67 më lart, në § 30). Paneli thekson që, në të vërtetë, PSSP-ja në mënyrë të heshtur pranon që UNMIK-u e kishte një përgjegjësi të tillë për të marrë masa lidhur me ndërprerjen e pagesave të pensionit në Kosovë, meqë ai e potencon faktin që zyrtarët e UNMIK-ut ishin mandatuar në një numër rastesh të trajtojnë këtë çështje me autoritetet serbe (shih §§ 44-47 më lart).

70. Duke pasur parasysh ekzistencën e obligimeve pozitive të UNMIK-ut sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me ankesën e ankuesit, Paneli duhet të

vlerësojë nëse UNMIK-u miratoi masa adekuate, në kuadër të kufizimeve të autoritetit dhe mandatit të vet, për t'i mbrojtur dhe garantuar të drejtat në pension të ankuesit.

71. Paneli thekson se, siç është thënë nga PSSP-ja, në mes vitit 1999 dhe 2002 ishin bërë përpjekje diplomatike në forma të një varg takimesh "pa u shprehur hapur dhe konfidenciale" në mes zyrtarëve të UNMIK-ut dhe autoriteteve serbe, në të cilat ishte trajtuar "çështja e pensioneve" (shih §§ 45-47 më lart), megjithëse kjo kohë është jashtë juridiksionit të vet kohor. Paneli nuk është bindur se janë marrë masa konkrete gjatë kësaj periudhe për t'i mbrojtur të drejtat në pension të atyre që kishin të drejtë, duke përfshirë ankuesin, meqë asnjë dokumentacion mbështetës nuk është ofruar nga PSSP-ja, i cili qartëson shtrirjen apo rezultatin e përpjekjeve të tilla diplomatike.

72. Megjithatë, Paneli po ashtu thekson se në përpjekje për të zgjidhur problemin e pensioneve në Kosovë, në vitin 2001, UNMIK-u krijoi nga fillimi një Skemë të re pensionale në Kosovë, e cila u bë funksionale duke filluar nga viti 2002. Paneli thekson që ky sistem u ofroi pensione bazë të moshës të gjithë atyre mbi 65 vjeç, pavarësisht nga ndonjë punësim i mëparshëm. Shuma mujore e këtij pensioni ishte 28 euro në vitin 2002, 35 euro në vitin 2003 dhe 45 euro nga viti 2004 deri më 2008.

73. Duke ardhur te periudha nën juridiksionin e përkohshëm të Panelit, nga 23 prilli i vitit 2005, Paneli thekson që ankuesi ishte kualifikuar të pranojë një pension bazë të moshës sipas Skemës pensionale të Kosovës të krijuar nga UNMIK-u që nga viti 2003, kur ai u bë 65 vjeç. Në të vërtetë, sipas një vendimi të Gjykatës Supreme të paraqitur nga ankuesi, ai e kishte pranuar një pension të tillë që nga maji i vitit 2003 (shih § 31 më lart).

74. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli konsideron se UNMIK-u, në kuadër të kufizimeve të kompetencave të veta dhe në pajtim me mandatin e vet sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999), ndërmori të gjitha hapat e mundshëm për t'i përmbushur obligimet e veta pozitive sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Prandaj, Paneli konstaton se UNMIK-u nuk e shkeli të drejtën e ankuesit në pronë.

b. Shkelja e pretenduar e nenit 9 dhe 11 të KNDESK-së

i. Parimet e përgjithshme

75. Ankuesi ankohet se mospagesa e pensionit të tij kontribuues gjatë periudhës prej vitit 1999 deri më 2007, dhe mosqenia adekuate e pensionit të moshës që i ishte dhënë atij më pas, përbënte një shkelje të të drejtave të tij për sigurim social dhe për standard adekuat të jetesës (Nenet 9 dhe 11 të KNDESK-së).

76. Të dyja, e drejta për një standard adekuat të jetesës dhe e drejta për sigurim social janë përfshirë në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), në të cilën thuhet se "secili, si pjesëtar i shoqërisë, ka të drejtë në sigurim social" (Neni 22, DUDNJ) dhe që "secili ka të drejtë për një standard të jetesës që është adekuat për shëndetin dhe mirëqenien e vetes dhe familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, strehimin dhe përkujdesjen mjekësore dhe shërbimet e nevojshme sociale, dhe të drejtën për sigurim në rast të papunësisë, sëmundjes, paaftësisë, të qenit i vejë, pleqërisë apo mungesës tjetër të mjeteve për jetesë në rrethana jashtë kontrollit të tij" (Neni 25.1, DUDNJ).

77. E drejta në sigurim social dhe e drejta në standard adekuat të jetës, po ashtu, garantohen në KNDESK, në të cilën në pjesët relevante thuhet:

Neni 9

"Palët shtetërore në Konventën aktuale njohin të drejtën e secilit në siguri sociale, duke përfshirë sigurimin social".

Neni 11.1

"Palët shtetërore në Konventën aktuale njohin të drejtën e secilit në një standard adekuat të jetesës për veten dhe familjen e vet, duke përfshirë ushqimin adekuat, veshmbathjen dhe strehimin, dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetës. Palët shtetërore do të ndërmarrin hapa të duhur për të siguruar realizimin e kësaj të drejte, duke pranuar për këtë qëllim rëndësinë esenciale të bashkëpunimit ndërkombëtar …"

78. Paneli thekson që e drejta në sigurim social është afirmuar fuqishëm në të drejtën ndërkombëtare, duke u materializuar në disa traktate ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (Neni 5 (e) (iv), Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (Neni 11 dhe 14) dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve (Neni 26), traktatet e ILO-s (ONP-së).

79. Në komentin e vet të përgjithshëm nr. 19 *mbi të Drejtat në Sigurim Social (Neni 9),* Komiteti i KNDESK-së ka shpjeguar në detaje veçoritë kryesore të kësaj të drejte dhe shtrirjen e obligimeve të palëve shtetërore. E drejta në sigurim social përfshin të drejtën për qasje dhe shfrytëzim të mbrojtjes nga rreziqet sociale dhe pasiguritë, veçanërisht ato që rezultojnë nga rrethanat jashtë kontrollit të njerëzve, siç janë "të ardhurat në lidhje me punën për shkak të sëmundjes, paaftësisë, lindjes, lëndimit në punë, papunësisë, moshës së shtyrë apo vdekjes së një anëtari të familjes, qasjes së papërballueshme në përkujdesje shëndetësore apo përkrahjes së pamjaftueshme familjare …"[2]. Në këtë kontekst, palët shtetërore obligohen të sigurojnë në mënyrë progresive të drejtën në sigurim social për të gjithë personat në territoret e tyre, duke siguruar mbrojtje specifike për personat dhe grupet e pafavorizuara dhe të margjinalizuara[3].

80. Në mënyrë specifike për personat e moshuar, të përcaktuar të jenë ata të moshës 60 vjeç e më lart, Komiteti ka konsideruar se, së bashku me ata të cilët janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe situata financiare e të cilëve është e pranueshme, ka shumë që nuk kanë mjete adekuate të mbështetjes, dhe të cilët janë në mesin e grupeve më të cenueshme, margjinale dhe të pambrojtura[4]. Për këtë arsye, dhe duke marrë parasysh se nuk ka asnjë instrument detyrues për të drejtat e njeriut që në mënyrë specifike mbron

---

[2] Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 19 për të Drejtën në Sigurim Social (Neni 9), i miratuar më 4 shkurt 2008, Dok. i OKB-së E/C.12/GC/19, në § 2.

[3] Raport i ekspertes së pavarur për çështjen e të drejtave të njeriut dhe varfërinë e skajshme, Magdalena Sepúlveda Carmona, 31 mars 2010, Dok. i OKB-së A/KDNJ/14/31, në § 47.; shih gjithashtu Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 3 për Natyrën e Obligimeve të Palëve Shtetërore (Neni .2 Para. 1 i Konventës), 14 dhjetor 1990, Dok. i OKB-së E/1991/23, në § 12.

[4] Komiteti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 6 për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të Personave të Moshuar, 8 dhjetor 1995, Dok. i OKB-së E/1996/22, në § 17.

të drejtat e personave të moshuar, Komiteti ka konsideruar se autoritetet obligohen sipas Konventës t'i kushtojnë vëmendje specifike promovimit dhe mbrojtjes të të drejtave të personave të moshuar, veçanërisht në kohë të "recesionit" dhe "ristrikturimit të ekonomisë", kur ata janë veçanërisht në rrezik[5].

81. E drejta në sigurim social mund të sigurohet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë skemat e bazuara kontribuuese/të sigurimit dhe skemat jokontribuuese/universale. Megjithatë, sipas Komitetit, një skemë e sigurimit social në pajtim me standardet e Konventës duhet sipas ligjit t'iu sigurojë personave të moshuar, duke filluar në një moshë specifike dhe në kuadër të limiteve të burimeve në dispozicion, përfitime jokontribuuese të moshës së shtyrë, si dhe shërbime sociale dhe ndihmë tjetër për ata që nuk u është ofruar një sistem i bazuar në-sigurim[6].

82. Komiteti i KNDESK-së ka theksuar që "sigurimi social është i një rëndësie qendrore për garantimin e një jete me dinjitet"[7], duke theksuar marrëdhënien në mes kësaj të drejte dhe realizimit të të drejtave tjera ekonomike dhe sociale, të drejtave të njeriut, kryesisht të drejtës në standard adekuat të jetesës dhe të drejtës në shëndet. Në lidhje me këtë, në respekt të parimit për dinjitet njerëzor që e përmban preambula e Konventës[8], është vendosur mirë që, pavarësisht nëse janë në para të gatshme apo në të mira materiale dhe përveç të të qenit në dispozicion, të qasshme dhe të përballueshme, përfitimet pensionale duhet të jenë adekuate "në shumë dhe kohëzgjatje me qëllimin që secili të realizojë të drejtat e tij/saj për mbrojtje dhe asistencë familjare, një standard adekuat të jetesës dhe qasje adekuate në përkujdesje shëndetësore". Veç kësaj, kriteret e të qenit adekuat duhet të monitorohen rregullisht për të siguruar që përfituesit i kanë të mirat dhe shërbimet që ata i kërkojnë për t'i realizuar të drejtat e tyre të Konventës[9].

83. Pranohet se, në pajtim me nenin 2 të KNDESK-së i cili ka të bëjë me shtrirjen e obligimeve të shteteve sipas Konventës, realizimi i plotë i të drejtës për sigurim social dhe të drejtës për standard adekuat të jetesës mund të arrihet vetëm "në mënyrë progresive", deri në maksimumin e burimeve në dispozicion të shteteve. Megjithatë, është e kuptueshme se këto dispozita të KNDESK-së, po ashtu, imponojnë obligimet të cilat janë me ndikim të menjëhershëm. Këto përfshijnë: obligimin për të garantuar se ushtrimi i këtyre të drejtave duhet të jetë i lirë nga diskriminimi dhe siguron së paku të gëzuarit e "niveleve esenciale minimale" të secilës nga të drejtat në fjalë[10].

84. Ky obligimi i fundit, në lidhje me të drejtën në sigurim social, kërkon sigurimin e qasjes në një skemë të sigurimit social që ofron "një nivel minimal të përfitimeve për të gjithë individët dhe familjet që do t'u mundësojnë atyre të marrin së paku përkujdesje esenciale shëndetësore, strehë dhe banim elementar, ujë dhe instalime hidrosanitare, gjëra ushqimore dhe format më themelore të arsimimit"[11].

---

[5] *Ibid, në* § 13.
[6] *Ibid*., në § 30; dhe Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 19 i përmendur në § 79 më lart, në § 15.
[7] *Ibid.*, në § 1.
[8] *Ibid*., në § 22.
[9] *Ibid*.
[10] *Ibid.*, në § 40; shih gjithashtu Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 3 përmendur në fusnotën 3, në § 10.
[11] Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 19, përmendur në § 79 më lart, në § 59; të lexohet në lidhje me Komentin e përgjithshëm nr. 14 mbi të Drejtën për Standardin më të Lartë të Arritshëm të Shëndetit (Neni 12), 11 gusht 2000, Dok. i OKB-së E/C.12/2000/4, në §§ 43 dhe 44.

85. Në kontekst të së drejtës të personave të moshuar për standard adekuat të jetesës, Komiteti ka konsideruar që, në pajtim me nenin 1 të Parimeve të OKB-së për Personat e Moshuar të miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm në vitin 1991, neni 11 i KNDESK-së kërkon që personat e moshuar duhet të kenë së paku qasje në ushqim adekuat, ujë, strehim, veshmbathje dhe përkujdesje shëndetësore përmes sigurimit të të hyrave, përkrahjes për familjen dhe komunitetin dhe vetëndihmës[12].

86. Komiteti ka nënvizuar që obligimet minimale bazë të cekura më lart, vlejnë "po ashtu në kohë të kufizimeve të mëdha në burime", ku autoritetet kanë obligime t'i mbrojnë "personat e cenueshëm të shoqërisë" (Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 3 përmendur më lart, në § 12). Veç kësaj, vëmendje e veçantë duhet kushtuar asaj që të sigurohet që sistemi për sigurim social të mund të përgjigjet në kohë të emergjencave, sikur gjatë dhe pas një fatkeqësie të natyrës, konflikti të armatosur dhe dështimi në prodhim të të lashtave[13]. Me qëllim që autoritetet të shmangin përgjegjësinë në përmbushjen e së paku obligimeve minimale bazike, ato duhet të demonstrojnë se të gjitha përpjekjet janë bërë për t'i shfrytëzuar të gjitha burimet që janë në dispozicion të tyre për t'i përmbushur, si çështje prioriteti, këto obligime minimale bazike[14].

ii. Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rastin aktual

87. Paneli thekson se në rastin aktual, ankuesit i ishin ofruar përfitimet sipas ish-sistemit jugosllav, dhe në mënyrë specifike një pension kontribuues i barasvlershëm me 180 euro në muaj, të cilat ai i pranoi deri në dhjetor të vitit 1998.

88. Paneli, po ashtu, thekson që për shkak të situatës politike pas konfliktit të Kosovës dhe nxjerrjes së Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999), nën administrimin e UNMIK-ut gjatë periudhës 1999-2001, ankuesi nuk kishte përfitime pensionale dhe ndonjë mbrojtje tjetër sociale.

89. Megjithatë, Paneli po ashtu thekson që, duke filluar nga viti 2002, UNMIK-u veproi në pajtim me obligimin e vet sipas KNDESK-së, në mënyrë specifike nenit 9 të Konventës, për të krijuar një skemë të sigurimit social e cila përfshinte jokontribuuesit dhe kontribuuesit, pensionet e moshës, dhe të fundit ofroheshin sipas ligjit nga mosha 65 vjeç. Paneli thekson më tutje se kjo skemë fillimisht nuk përmbante dispozitat për ata punëtorë të cilët kishin paguar kontribute në ish-sistemin jugosllav, sikur ankuesi. Megjithatë, sipas kësaj skeme, ankuesi mori që nga momenti kur e fitoi të drejtën në vitin 2003 një pension të moshës, shuma fillestare e të cilit ishte 35 euro në muaj.

90. Duke ardhur te periudha nën juridiksionin e vet, Paneli thekson se ankuesi pranoi në këtë periudhë një pension të moshës prej 45 eurosh në muaj. Vetëm nga shtatori i vitit 2009, jashtë juridiksionit të përkohshëm të Panelit, ankuesi filloi të marrë një pension kumulativ prej 80 eurosh, duke u bazuar në moshën e tij si dhe kontributet e mëparshme në Sistemin pensional jugosllav (shih § 31 më lart).

---

[12] Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 6, përmendur në fusnotën 4, në § 32.
[13] Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 19, përmendur në § 79 më lart, në § 50.
[14] *Ibid.*, në § 60.

91. Paneli konsideron se, përmes krijimit të një skeme pensionale në Kosovë, e cila përfshinte kontribuuesit dhe jokontribuuesit e moshuar, UNMIK-u veproi në pajtim me obligimet e veta sipas KNDESK-së, dhe në veçanti sipas nenit 9 të Konventës.

92. Megjithatë, Paneli është i shqetësuar që shuma mujore e pensionit për të moshuar e paraparë në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/31 dhe si e tillë i është ofruar ankuesit në periudhën nën juridiksionin e Panelit - 45 euro në muaj, që është rreth një euro e gjysmë në ditë – nuk ishte adekuate për t'i siguruar qasje ankuesit në shërbimet themelore dhe të mirat e nevojshme për realizimin e një standardi adekuat të jetesës dhe shëndetit. Në lidhje me këtë, Paneli e ka parasysh deklaratën e ankuesit se pensioni i tij nuk ishte madje i mjaftueshëm për t'i blerë barnat që atij i nevojiteshin.

93. Paneli e merr parasysh më tutje faktin se për personat e moshuar, sigurimi social dhe shëndeti janë të lidhura ngushtë, meqë shpenzimet për përkujdesje shëndetësore llogaritet të jenë tri të katërtat e të ardhurave të grupeve më të varfra[15]. Është treguar se, në këto rrethana, "ndikimi pozitiv i iniciativave për mbrojtje sociale lidhur me standardin e jetesës të personave të moshuar mund të mos jetë efektiv nga barra e shkaktuar nga shpenzimet e ndërlidhura me shëndetin"[16].

94. Paneli thekson se vlerësimi i të qenit adekuat të pensionit dhe përfitimeve të tjera sociale mund të jetë detyrë komplekse dhe e vështirë, veçanërisht duke e pasur parasysh se nuk duket të ketë konsensus të gjerë në mesin e ekspertëve mbi atë se çfarë përbën masën më të mirë për të qenit adekuat të pensionit. Megjithatë, Paneli i kushton konsideratën e duhur vlerësimit të bërë nga Komiteti i KNDESK-së në nëntor të vitit 2008, që nivelet minimale të përfitimeve bazë nga pensionet për të moshuar duke përfshirë ato të kontributit-dhe bazë" të siguruara nga UNMIK-u në Kosovë ishin "të pamjaftueshme për të siguruar standard adekuat të jetesës për përfituesit dhe familjet e tyre"[17]. Paneli, po ashtu, thekson se një vlerësim i ngjashëm gjendet në mesin e burimeve tjera në një raport të vitit 2012 të Grupit për Studime Juridike dhe Politike[18]. Raporti, i financuar nga UNDP, konstaton se shuma e pensionit bazë është joadekuate për të garantuar standard të mirë të jetesës në Kosovë. Në raport thuhet se është llogaritur që "për konsumim normal të ushqimit në Kosovë, një personi i nevojiten 3.01 € në ditë"; prandaj me një pension prej 35/80 eurosh "një pensionist nuk është në gjendje t'i heqë vetëm shpenzimet e ushqimit, madje edhe nëse strehimi dhe shpenzimet mjekësore tanimë janë hequr" dhe që "pensionistët janë lënë në gjendje të mjerë të varfërisë, duke jetuar me vetëm 1,5 € në ditë"[19]. Në raport, po ashtu, thuhet se pensionet bazë në Kosovë nuk i janë nënshtruar indeksimit siç parashihet me ligj, por janë rritur lehtë në vitin 2003, 2004 dhe 2009 në bazën ad hoc[20].

---

[15] Raporti i ekspertes së pavarur mbi çështjen e të drejtave të njeriut dhe varfërinë e skajshme, Magdalena Sepúlveda, përmendur në fusnotën 3 më lart, në § 90.
[16] *Ibid.*
[17] Komiteti i KNDESK-së, *Vlerësimi i raporteve të dorëzuara nga palët shtetërore sipas neneve 16 dhe 17 të Konventës, Dokument i dorëzuar nga Administrata e Përkohshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK),* 19 nëntor 2008, Dok. i OKB-së E/C.12/UNK/CO/1, në § 21.
[18] Grupi për Studime Juridike dhe Politike, *Sistemi pensional në Kosovë: Shqyrtim i gjendjes së tanishme, sfidat kryesore dhe zbrazësitë,* dhjetor 2012, i qasur në http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy%20Report%2006%202012%20eng.pdf, më 15 maj 2016.
[19] Në f. 15.
[20] Në f. 8.

95. Paneli, po ashtu, thekson se nuk është paraqitur asnjë argument apo dëshmi nga PSSP-ja se ankuesi mund të ketë shfrytëzuar për periudhën në shqyrtim burime tjera të të ardhurave apo të hyrave për të mbajtur një standard të mirë të jetesës.

96. Paneli rikujton më tutje që është një parim i provuar mirë se obligimet minimale bazike sipas Konventës vlejnë, dhe veçanërisht edhe më shumë për personat më të cenueshëm dhe të margjinalizuar, madje edhe në kohën e kufizimeve në burime apo pas një konflikti sikur në rastin e Kosovës dhe hedh poshtë argumentin e PSSP-së në lidhje me këtë (shih § 66 më lart).

97. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli konsideron se në rrethana të veçanta të këtij rasti dhe në mungesë të informatave tjera, duke i ofruar ankuesit një pension të moshës joadekuat për të siguruar standard adekuat të jetesës, UNMIK-u nuk përmbushi obligimet e veta bazike sipas nenit 9 dhe 11 të KNDESK-së. Prandaj, Paneli konstaton se këto dispozita janë shkelur.

98. Duke pasur parasysh të gjeturat e veta sipas neneve 9 dhe 11 të KNDESK-së, Paneli konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ndaras bazueshmëria e ankesave esencialisht identike të ankuesit të bëra sipas nenit 3 të KEDNJ-së (shih GJEDNJ, *Teshiq kundër Serbisë*, nr. 4678/07 dhe 50591/12, vendimi i 11 shkurtit të vitit 2014, në § 67).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

1. KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KEDNJ-së;

2. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENEVE 9 DHE 11 TË KNDESK-së;

3. KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOHET ANKESA SIPAS NENIT 3 TË KEDNJ-së.

4. REKOMANDON QË UNMIK-u:

a. TË PRANOJË DËSHTIMIN E VET PËR T'I PËRMBUSHUR OBLIGIMET E VETA SIPAS NENEVE 9 DHE 11 TË KNDESK-së, DHE T'I KËRKOJË FALJE ANKUESIT;

b. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESIT PËR DËMIN MORAL NË LIDHJE ME GJETJEN E SHKELJEVE TË NENEVE 9 DHE 11 TË KNDESK-së;

c. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR TEK AUTORITETET RELEVANTE NË KOSOVË QË TË SIGUROJNË QË PËRFITIMET E SIGURIMIT SOCIAL, DUKE PËRFSHIRË PENSIONET E MOSHËS, OFROHEN NË PAJTIM ME STANDARDET E APLIKUESHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT;

d. TË MARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIN DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.

Andrey Antonov	Marek Nowicki
Zyrtar ekzekutiv	Kryesues